



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Letërsi e Gjuhës B(3)

Ngarkesa: 4 ECTS, 20 orë leksione, 20 orë seminare

Viti / Semestri : Viti III, Semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor “Gjuhë, letërsi dhe qytetërim francez”

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Të kuptohet konteksti historik dhe qëllimi artistik e social i lëvizjeve më të mëdha të shek. të XIX dhe XXTë mësohet dhe të kuptohet poezia në sajë të karakteristikave të përgjithshme të lëvizjes dhe nëpërmjet individualitetit të çdo poeti. Të dimë të dallojmë poezi të ndryshme sipas përkatësisë. Të analizojmë lëvizjet dhe periudhat historike nëpërmjet poezisë. Karakteristikat e poezisë franceze në raport me atë evropiane.

Objektivat specifike lëndore:

1. Propozojmë fillimisht një prezantim të shkurtër të kontekstit historik.
2. Të japim, gjithashtu, një panoramë kronologjike të asaj çka shek. i XIX dhe XX sollën në poezinë franceze.
3. Më tej, çdo lëvizje letrare dhe artistike ka « dishepujt » e saj, por edhe « thyesit e rregullave ».
4. Përqëndrohemi mbi të gjitha tek poetët avangardë dhe poetët zëdhënës të kohës së tyre

Rezultatet e pritshme :

Në përfundim të këtij moduli studentët do të jenë të aftë :

- Të vendosin një lidhje logjike dhe të argumentuar midis lëvizjeve të ndryshme letrare dhe poezive që u përkasin ;
- Të kuptojë si dhe pse poezia reflekton njeriun, jetën e tij dhe visionin e tij subjektiv mbi botën ;

Të kuptojnë rëndësinë, zhvillimin dhe « mesazhin » e poezisë moderne franceze.